

FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Bordi i FMK-së në bazë të nenit 41 paragrafi 12 pika (b) të Statutit të Federatës së Mundjes të Kosovës, në mbledhjen e vetë të mbajtur 06.10.2022 miratojë:

RREGULLORJA E KOMISIONIT DISCIPLINORE

Dispozitat e Pergjithshme

Neni 1

Rregullorja disiplinore e Federates se Mundjes të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KD) përcakton masat dhe procedurat për ndëshkimin e mundesave, gjyqtarëve, trajnerëve, anëtarëve FAK-ut dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë për shkeljeve të kryera e të përshkruara në këtë Rregullore dhe aktet e tjera të KD, në ligjin në fuqi dhe dënimet, sipas kryerësve të shkeljeve.

DËNIMI

Neni 2

Kryerësi që ka kryer shkeljen dënohet për këtë shkelje, nëse kryhen me qëllim /dashje/ose nga pakujdesia. Për shkeljen e cila është kryer nga pakujdesia mundë të dënohen më lehtë.

QELLIMI I DËNIMIT

Neni 3

Qëllimi i dënimit disiplinor është parandalimit për të parandaluar personat nga neni 1. për të kryer shkeljet dhe edukimi i tyre të ndikojnë në vetëdënimin e kryerësve për të kuptuar se janë të papranueshme sjelljet e pahishme në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje ose akte të tjera të përfshira në neni 1 të kësaj rregullore.

SHTYTJA DHE NDIHMA .

Neni 4

Kushdo që shtyt (nxitë) ose ndihmon atë që të kryejë një shkelje, do të dënohet si shkelësi, por që ndihmësi do të dënohet më lehtë .

TENTATIVA


Neni 5

Një veprë disiplinore është tentuar kur kryerësi me dashje ka filluar një veprim shkeljes por që deri te pasoja nuk ka ardhur. Një tentativë dënohet vetëm për ato veprime (shkelje) për të cilat me këtë rregullore janë përcaktuar. Veprimi I mbetur në tentative dënohet më pak se shkelja e kryer.

MATJA E DENIMIT

Neni 6

Autoriteti kompetent do të matë dënimin e kryerësit Brenda kufijve të përcaktuar me këtë rregullore. Do të marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat ndikojnë në ndëshkimin më



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

të madh apo më të vogël, dhe në veçanti: peshën e shkeljes disiplinore dhe pasojat e tij, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, shkalla e përgjegjësisë së shkelësit, ndalimi i shkelsit pas shkeljes dhe nëse autori i shkeljes është përsëritës-dënohet më parë për të njëjtin ose një vepër të ngjashme.

Nëse janë vërtetuar rrethana të posaçme lehtësuese ose shkeljen e ka kryer personi që është i mitur për shkeljen e kryer në vend të atij të parapar, mundë ti shqiptohet vërejtja ose qortimi, në vërtet të matet dënimi nën kufirin e parashikuar apo të shqiptohet ndonjë dënim më I lehtë.

PARASHKRIMI

Neni 7

Procedurat disiplinore nuk mund të iniciohen nëse kërkesa është paraqitur për 30 ditë pas kryerjes së shkeljes përveç nëse është në pyetje shkelja në vend. Parashkrimi mundë të ndërpritet me ndërmarjen e secilit veprim të trupit të Komisionit disiplinor të ndërmar në zhvillimin (udhëheqjen, inicimin) e procedurës disiplinore. Procedura disiplinore nuk mundë të zhvillohet pasi që ka kaluar një vit nga dita e kryerjes së shkeljes (kundërvatjes).

DENIMI PA INTERVISTIM


Neni 8

Askush nuk mundë të dënohet para se të intervistohet për shkeljen që i vëhet në barë si dhe rrethana nën të cilat është kryer. Konsiderohet se shkelsi është intervistuar kur në ftesën nga organi kompetent jep deklaratën qoftë në mënyrë verbale gjatë seancës dëgjimore pran Komisionit Disiplinor, apo kur e parashtron deklaratën e tijë me shkrim, dhe nëse është i ftuar në mënyrën e rregullt nuk i përgjigjet ftesës për dhënjen e deklaratës e as në afatin e parashtruar nuk parashtron mbrojtjen e tijë me shkrim, në këtë rast do të konsiderohet që e ka shfrytëzuar të drejtën e tij në mbrojtje.

SHLYERJA E DENIMIT

Neni 9

Do të konsiderohet se nuk dënohet: - Shkelësi i shkeljes disiplinore që është i dënuar me një paralajmërim, që Brenda gjashtë (6) muaj nuk kryejnë një shkelje të re disiplinore, - Shkelësi i një shkeljes disiplinore të dënueshme me ndalim të paraqitjes në gara, ushtrimit të funksionit në afat gjerë në një vit (1) ose gjobë dhe brenda dy (2) viteve pas mbajtjes së dënimit nuk kryen ndonjë shkelje të re. - Shkelësi i një shkeljes disiplinore të dënuar me dënimit më të rëndë se në pikën paraprake një gjobë më të rëndë se ajo pikës parapraket në afat deri në pesë (5) vite deri në mbajtjen e dënimit nuk kryen një shkelje të re dicipinore .



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTETIPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

II- DENIMET DISIPLINORE

Neni 10

Dënimet disiplinore janë: 1. Për mundesin-en a) Vërejtje, b) Një ndalim të pjesëmarrjes për një periudhë të caktuar kohe, c) Ndalimi i pjesëmarrjes në një numër të caktuar garash, d) Ndalimi të paraqitjes jashtë vendit, e) Përrjashtimi nga FMK.

2. Për personat përgjegjës, trajnerët, gjyqtarët: a) Vërejtje, b) Ndalimi i ushtrimit të një funksioni për një kohë të caktuar, c) Përrjashtimi nga FMK. 3. Për anëtarët: a) Vërejtje, b) Dënimi me gjobë c) Ndalimi i paraqitjes në vend dhe jashtë vendit në afatin e caktuar kohor ose në numrin e caktuar të garave. d) Përrjashtimi nga FMK .

VEREJTJA


Neni 11

Dënime me vërejtje shqiptohet për shkeljet disiplinore të cilat janë kryer nën rretha lehtësuese, në mënyrë që të bëhen më të lehta .

NDALIM NE PJESEMARRJE

Neni 12

Dënimi në ndalim të pjesëmarrjes mundë të jetë në periudhë të caktuar kohore apo në numrin e caktuar të garave. Dënimi në ndalim të pjesëmarrjes në periudhë të caktuar kohore mundë të zbatohet gjerë në dy (2) vite, ndërsa dënimi në mos pjesëmarrjen në një numri të caktuar të garave mundë të zbatohet deri në dhjet (10) gara. Dënimi në ndalim të pjesëmarrjes në numrin e caktuar të garave mundë të zëvendësohet në vend të dënimit me ndalim të pjesëmarrjes në periudhën e caktuar kohore gjerë në 10 muaj, me atë të ndalimit të pjesëmarrjes në një (1) garë që i përshtatet me ndalim të pjesëmarrjes në periudhën kohore prej një muajin (1) . Dënimi kohore me ndalim të pjesëmarrjes si dhe dënimi në ndalim në pjesëmarrje në një numër të caktuar garash mundë të shqiptohet si për garat ekipore ashtu edhe në garat individuale. Dënimi i ndalimit të pjesëmarrjes në garat ndërkombëtare nuk mundë të jetë më gjatë se tri vite. Nëse garuesit (mundes-e) ose anëtari është i dënuar me ndalim të përfaqësimit ndërkombëtar, dënimi nuk ka të bëjë me pjesëmarrjen në përbërje të përfaqësuese Kombëtare. Dënimi në ndalimin e ushtrimit të funksionit vlen në ndalimin e pjesëmarrjes dhe anashjelltas.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHITËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

PËRJASHTIMI

Neni 13

Përrjashtimi i mundesit-ses, personit zyrtar, anëtar të bordit drejtues në mënyrë automatike, përfshin dënimin e ndalimit të pjesëmarrjes në kohëzgjatje gjerë gjashtë (6) muaj, e cila nuk mundë të zëvendësohet me dënimin të ndalimit për pjesëmarrjen në numrin e caktuar të garave.

NDALIMI NE KRYERJEN E FUNKSIONIT

Neni 14

Dënimin në ndalimin e funksionit mundë të shqiptohet në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh. Personi i dënuar me këtë lloj të dënimin nuk mundë të kryej asnjë funksion në cilën do trup në të cilën është anëtar i federatës, komisionet, shoqatat, klubeve, të garave, që është anëtar i clit do trup tjetër gjerësa të zgjasë dënimin. Dënimin i ndalimit në ushtrimin të funksionit përfshin ndalim në pjesëmarrje, edhe të personit të dënuar nëse është atlet.

DENIMI ME GJOB

Neni 15

Lartësin e dënimin me gjob (në të holla) do ta përcaktojn anëtarët e bordit të FMK-se. Dënimin në të holla duhet paguar gjerë në afatin 15 prej ditësh prej momentit kur vendimit është bërë i plotëfuqishëm. Vendimit për dënimin të cilën e shqipton trupi vepron në kuadër të atij trupin dhe është i efekshëm vetëm brenda atij trupit. Ku dënimin do të jetë i vlefshëm në kuadër të FMK-se, vetëm nëse në propozim të anëtarit, ka vërtetuar Komisionin disiplinor i FMK-se- të shkallës së dytë i cili mundë ta zbus dënimin të cilin e ka nxjer shkalla e parë. Ankesa duhet të dërgohet në afat prej 15 ditësh prej momentit të plotëfuqishmëris së vendimit duke i bashkangjitur të gjitha provat materiale.

III- SHKELJET INDIVIDUALE


Neni 16

Mundesat-et, anëtarët e FMK-se, personat e tyre përgjegjës dhe gjyqtarët mund të ndëshkohen për e shkeljet e kryera të përshkruar në këtë kapitull të Rregullores ose të përcaktuar nga një tjetër aktet e FMK-se, në përpythje me ligjet në fuqi të Kosovës.

MOS PJESEMARRJA NE GARAT

Neni 17

Nxijtja e mundesav-e që të mos fillojnë ose të largohen nga konkurrenca, dënohet me mos pjesëmarrjen ose ushtrimin (kryerjen) e funksionit, prej tre deri në gjashtë muaj. Mundesi i cili nuk fillon ose largohet nga gara, ndëshkohet për mos pjesëmarrje prej tre deri në gjashtë muaj, anëtar i të cilit është mundë të dënohet me gjob. Për tentativ të veprës nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dënohet.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTETËRIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

PJESEMARRJA JO E RREGULLT

Neni 18

Atlet i cili merr pjesë në gara pa qen i rregulluar statusi i tij i anëtarësimi në FAK, ose nuk ka fituar ende të drejtën për pjesëmarrje, nuk disponon me kontrollim mjekësor apo mjeku nuk ja ka lejuar pjesëmarrjen, gjendet në suspension ose i dënuar –dënohet me paraqitjen prej dy deri në gjashtë muaje, personi përgjegjës i klubit, trupi tjetër etj. Do të dënohet me mos ushtrimin e funksionit prej tre deri në tetë muaj.

MOS ARDHJA NE GARE

Neni 19

Mospjesëmarrja e pajustificuar i një anëtar i ose një individ i në Kampionat, apo garë individuale apo ekipore për të cilat ata janë paraqitur, është kundërvatje anëtar i do të dënohet me dënim me të holla sipas vendimit të FMK-se, dhe një mundesi, trajner dhe person përgjegjës (zyrtar)dënohet me ndalim të kryerjes së funksionit prej një gjerë në tre muaj.

SULM FIZIK

Neni 20

Një sulm fizik gjatë garës, dmth para ose pas garës, dhe në lidhje me garimin dënohet me ndalim nga tre muaj deri në dy vjet ose duke përjashtuar nga FMK. Për tentative do të dënohet. Mbrojtja e nevojshme nga një sulmi fizik dënohet me një ndëshkim më të lehtë nëse nuk ka ardhur gjerë tek pasoja e rëndë.

ORGANIZIMI I DOBET I GARAVE


Neni 21

Dënohet sipas dispozitave të Rregullave të Përgjithshme të Komisionit të garues të FMK .

SJELLJA E PAHIJSHME SPORTIVE

Neni 22

Sjellja e pahishme sportive dënohet me vërejtje, por në rast të përsëritjes apo në rastin më të rëndë me ndalim të pjesëmarrjes apo në ushtrimin të funksionit prej një gjerë në tri muaj. Sjellja josp sportive nënkupton sharje, sjelljet e pa hishme (lëvizjet trupore) kundërshtimi I vendimit apo vendimit të pa përfunduar të gjyqëtarit , delegatit apo përgjegjësit (zyrtarit)tjetër të garave, provokimi I atletit të tij apo kundërshtarit, gjyqëtarit ,delegatit apo zyrtarëve përgjegjës në gara apo të shikuesve me fjalë apo gjeste apo cdo sjellje tjetër I cili mundë ta rënoj kredibilitetin apo autoritetin e sportit të atletikës .



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHITËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADAN" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

OFENDIMI DHE PERGOJIMI

Neni 23

Ofendimi, përhapja e thashethëmeve të pavërteta për anëtare të tij ose të tjerëve, për mundes të tijë apo mundesin e tjetër të klub, personit përgjegjës, gjyqëtarit, trenerit ose organit, është kundërvatje për të cilin mundesit, gjyqëtarit apo, trenerit apo personit përgjegjës do ti shqiptohet dënimit me ndalim të përfaqësimit gjegjësisht në kryerjen e funksionit prej një (1) gjerë në gjashtë muaj, klubin ose organin dënim me të holla. Në rastin më të rëndë apo rastin e përsëritjes mundesi, gjyqëtarit, treneri apo personi përgjegjës personi dënohet me ndalim të përfaqësimit gjegjësisht në ushtrimin e funksionit prej gjashtë (6) deri në një vit (1) ndërsa anëtarit dënim në të holla sipas vendimit të FMK-se.

MOS KRYERJA E OBLIGIMEVE (PERFUNDIMIT TE OBLIGIMEVE)

Neni 24

Mos kryerja apo kryerja me vones dhe dorëzimi I raportit të garave, mos pagesa e gjyqëtarve apo delegatit apo të shpenzimeve të tjera të parapra me rregulloren e garave, mos dorëzimi i librezave të anëtarimit (regjistrimit)të mundesav apo dokumentacionit tjerë delegatit në shiqim kur ajo është paraparë me udhëzim, rregullore të garave, mos pagesa e anëtarimit apo të taksave të tjera për anëtar apo mundes-e ,mos paraqitja apo vonesat në paraqitjen e garave, vështërsimi i punës të organeve apo trupave të tjerë të FMK-se , mos parashtrimi apo vonimi në kryerjen e përgjegjësis, të dhënave, kuvendit apo të tjera , apo mos kryerja e cdo obligimit të cilat rrjedhin nga rregulloret të organeve (trupave)të FMK-se, është shkelje për të cilin personave përgjegjes i shqiptohet dënimi në ndalim të ushtrimit të funksionit prej një (1) gjerë në gjashtë (6) muaj, anëtarve dënimi në të holla sipas vendimit të FMK-se.

PARAQITJA DHE REGJISTRIMI I DHËNAVE TE GABUARA


Neni 25

Paraqitja e të dhënave të gabuara në kuvend apo Zyre (të FMK-se), dorëzimi I të dhënave të gabuara në zyrën e regjistrimit (Zyra e sekretaris së FMK-se) është shkelje për atë mundes të cilin personi përgjegjes dënohet me ndalim në ushtrimin e funksionit prej një (1) gjerë në gjashtë (6) muaj, ndërsa anëtarit me dënimi në të holla sipas vendimit të FMK-se.

MOS ZBATIMI RREGULLORES TEKNIKE (GARAVE)

Neni 26

Personi përgjegjës, gjyqëtar i cili me qëllim (dashje) gabimisht zbaton rregullat teknike të rregullorës të garave dënohet me ndalim të ushtrimit të funksionit prej dy (2) muaj gjerë në një vit .



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

PERDORIMI I PALEJUAR I MJETEVE DHE METODAVE STIMULUESE (DOPING)

Neni 27.

Përdorimi i palejuar i mjeteve dhe metodave të palejuara stimuluese (Doping) do të dënohet në përputhje me rregulloren Antidoping të UWW-se.

RASTET E TJERA

Neni 28

Çdo sjellje (veprim) i cili taksativisht nuk është i përcaktuar si shkelje ndërsa është i përcaktura me statutin dhe akte të tjera të FMK-se dënohet në pajtim me këtë rregullore përveç nëse me akte të vecant është parapar ndryshme .

IV- ORAGANI DISCIPLINOR

Neni 29

Komisioni disiplinor I Federatës se Munjdes të Kosovës është i autorizuar të vendos për të gjitha shkeljet të cilat i kan kryer mundesat-et në Kosove apo jashtë vendit. Komisioni disiplinor është autorizuar që të vendos edhe sipas kërkesës së jashtëzakoshme për zbutjen e dënimit sipas nenit 47. Të kësaj rregulloreje. Neni 30 Komisioni disiplinor përbëhet prej tre (3) anëtar nëse me aktet të tjera nuk është përcaktuar ndryshe Për të qen Vendimi i plotëfuqishem I Komisionit disiplinor duhet të vendoset me shumicën e votave.


PROCEDURA DISCIPLINORE INICIMI I PORCEDURES

Neni 31

Procedura disiplinore mundë të inicohet 1) Në bazë të raportit të delegatit, kryegjyqëtarit, gjyqëtarit në tapet apo personave të tjerë përgjegjës të garës. 2) Në bazë të fletëparaqitjes udhëheqësit të mundjës apo personave përgjegjes. 3) Në bazë të fletëparaqitjes së anëtarit apo mundsit 4) Në bazë të fletëparaqitjes të përbashkët të së paku (5) shikuesve 5) Sipas detyrës zyrtare. Fletëparaqitja dorëzohet Komisionit Disiplinor i cili vendos në iniciimin e procedurës.

Neni 32

Komisioni i disiplinor është i obliguar të inicoj cdo herë nëse është kryer njëra nga shkeljet e parashikuara me këtë rregullore. Komisioni disiplinor duhet të inicohet në afat prej tetë (8) ditësh nga momenti i pranimit të fletëparaqitjes dhe për këtë duhet të informohet kryerësi i shkeljes në formën me shkrim.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHITËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

RRJEDHJA E PROCEDURES

Neni 33.

Procedura disiplinore është urgjent Procedura disiplinore në shkallë të parë duhet të jetë e përfunduar në afat gjerë në tre (3) muaj, që nga momenti i dorëzimit të fletëparaqitjes ose raportimit të rastit. Nëse gjerë në këtë afat procedura disiplinore nuk është përfunduar, konsiderohet se është ndërprer, me crast parashtruesi I fletëparaqitjes apo raportit ka të drejtë në ankesë në shkallën e dytë

Neni 34

Në procedurën disiplinore duhet bërë intervistimi (ndëgjimi /dhënja e deklaratës) shkelësit (kryerësit) apo të dëshmitarëve nëse këtë e kërkon natyra e rastit. Nëse procedura disiplinore zhvillohet kundër anëtarit atëher duhet dhënë dëshmin kryetari apo ndonjë person tjerë e të cilin e ka autorizuar anëtarit.

NDERPRERJA E PROCEDURES

Neni 35

Kur komisioni disiplinor vërtetonte nuk është a arësytuar apo zhvillimi i mëtutjeshëm i procedurës disiplinore, merr (nxjerr) vendim për ndërprerjen e procedurës për të cilin me shkrim e njofton parashtruesit e fletëparaqitjes / raportimit. Kundër vendimit për ndërprerjen e procedurës disiplinore parashtruesi I fletëparaqitjes/raportimit ka të drejtë të parashtrorj ankesë organit disiplinor të shkallës së dytë në pajtim me këtë rregullore.

SHPENZIMET PROCEDURALE

Neni 36

Shpenzimet të procedurës disiplinore i bartë (kryerësi) shkeljësi kundër të cilit është shqiptuar dënimi. Në rast të ndërprerjes apo lirimit nga vendimit disiplinor, shpenzimet i bartë FMK . Komisioni disiplinor vendos se kush do ti bartë shpenzimet procedural.

SUSPENDIMI

Neni 37 .


Suspendimi mundë të jetë; a) Automatik b) Në bazë të vendimit të organit disiplinor

Neni 38

Suspendimi automatik pason (vjen) kur mundesi-ja me vendimit të gjyqëtarit përjashtohet nga garat për shkak të kryerjes së shkeljes . Organi disiplinor mundë ta nxjer (mer) vendim për ndërprerjen automatike të suspendimit nëse vendos se nuk është arësytuar mirë në bazë të natyrës së shkeljes (kundërvatjes) . Suspendimi automatik përllogaritet në dënim.

Neni 39

Suspendimi në bazë të vendimit të Komisionit disiplinor mundë të shqiptohet kur; a) Në rast kur është kryer kundërvatja ku në bazë të vlerësimit të Komisionit disiplinor ka pasoja më të rënda, vlen



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

gjerë në përfundimin e procedurës disiplinore nxjerjes së vendimit mbi ndalimin e pjesëmarrjes apo të ushtrimit të funksionit. b) Për shkak të mungesës në seanc ndëgjimore, suspendimi ndërpritet menjëher pasi që ketë dhënë dëshmin (dhënë deklarat) apo ka arësytuar mungesën. c) Në rast kur mundesi, personi përgjegjës, treneri, gjyqëtar i ndodhet në paraburgim (burgim) gjerësa ndërpritet paraburgimi. d) Për shkak të mos pagesës së dënimit me të holla, gjerë tek kryerja e pagesës. Koha e kaluar nën suspendim llogaritet në dënim, vetëm nëse është në pyetje suspendimi për shkak të mungesës në seanc dëgjimore apo suspendimi për shkak të mos pagesës.

VEDIMI I KOMISIONIT DISCIPLINOR

Neni 40

Vendimi i Komisionit Disciplinor duhet të përmbajë, shkeljen cila është vërë në barë, lloji i shkeljes, dënimi, dita prej kur fillon që të rrjedh vendimi, arësytimi dhe këshilla për të drejtën në ankes.

Neni 41

Komisioni disiplinor është i obliguar ta dorëzojë vendimin për dënimin në formë të shkruar, shkelësi i veprës në afat tre (3) ditësh, e në raste të vecanta në afat prej (8) ditësh të nxjerjes së tij.

PROCEDURA E ANKESES SI MJET I RREGULLT JURIDIK

Neni 42

Ankesës i bashkangjitet vërtetimi mbi pagesën e 100€, të cila kthehen me rastin e vërtetimit si të bazuar ankesën. Ankesa parashtrohet organit disiplinor të shkallës së parë në afat prej /8/ ditësh. Ankesa e parashtruar pas afatit të parashikuar kohor, organi disiplinor e hudh poshtë si të pabazuar. Nëse së bashku me ankesën nuk është bashkangjitur edhe pagesën do të thirret parashtruesi i ankesës që ta bëjë pagesën në afat prej tri (3) ditësh. Nëse pagesa nuk do të paguhet edhe pas afatit të parashikuar për ankes organit disiplinor do ta hudh ankesën. Ankesa kundër vendimit për suspendim nuk është e lejuar.

Neni 43


Ankesën mundë ta parashtrajn; a) I dënuari b) Parashtruesi i ankesës apo fletëparaqitësi c) Anëtar i ose atleti apo personi përgjegjës është i dënuar, d) Persona të tjerë përgjegjës ose anëtar Parashtruesi i fletëparaqitjes /raportit nuk paguan për prashtrim të ankesës.

Neni 44

Ankesa kundër vendim për dënim nuk e shtuen dënimin.

Neni 45

Organi disiplinor i shkallës së dytë duke vendosur për ankes, mundë të vendos me vendim; a) Lënda të ndërpritet dhe kthehet në shqyrtim organit disiplinor të shkallës së parë b) Vërtetoj c) Të shqyrtoj lidhur me rritjen apo uljen e dënimit apo sheljësi i shkelejes të lirohet nga përgjegjësia disiplinor. Dënim i nuk mundë të rritet nëse shkelësi vetëm ai e ka parashtruar ankesën. Organi disiplinor i shkallës së dytë vendimin e ti duhet nxjer (marr) në aftë prej 30 ditësh. Nëse organi i shkallës së dytë nëse vendimin nuk e nxjer nga paragrafi paraprak, konsiderohet se ankesa është hedhur poshtë dhe vendimi i shkallës së parë konsiderohet i vërtetuar (i plotëfuqishëm).



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

PERSERITJAE PROCEDURES

Neni 46

Procedura disiplinore paraparr në neni 1 dhe 2 në bordin e FMK-se mundë të përsëritet. a) Nëse vërteton nëse vendimi i plotëqishëm është nxjer mbi të fakteve të rrejshme. b) Nëse lindin faktet të reja ose prova në bazë të se cilës do të do të nxjeret një vendim më i favorshëm, e që ato prova të jen përdorur në procedurën e më herëshme.

Neni 47

Propozimin për përsëritjen e procedurës mundë ta parashtrojn personat ose organi nga neni 41 të kësaj rregulloreje në afat prej një (1) viti prej momentit dorëzimit të vendimit të plotëfuqishëm. Në të njëjtën kohë edhe organi disiplinor i cili ka nxjer vendim për dënimin në shkallën e parë mund ta përsëris procedurën sipas detyrës zyrtare nëse ekzitojn kushtet nga neni 46 të kësaj rregulloreje. Propozimi për përsëritjen e propozimit nuk ndalon e ekzekutimin e dënimit.


Neni 48

Propozimin për përsëritjen e procedurës i parashtrohet Komisionit disiplinor të shkallës së parë i cili e ka shqiptuar dënimin në shkallë të parë. Nëse Komisioni disiplinor vërteton se propozimi për përsëritjen e procedurës është i bazuar (ka bazë ligjore) do të zhvillohet procedurë e re në të cilin do të nxiret vendimi i ri . Kundër vendimit me propozim për përsëritjen e procedurës parashtruesi i propozimit ka të drejt organit disiplinor të shkallës së dytë t'ja parashtroj ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita dorëzimit të vendimit. Ankesës I bashkangjitet edhe dëshmia e pagesës e cila në rast të ankesës së bazuar kthehet. Shuma e pagesës për ankesë bëhet sipas vendimit të FMK-se.

ZBUTJA E JASHTEZAKONSHME E DENIMIT SI MJET I JASHTEZAKONSHEM JURIDIK

Neni 49

Kur konstatohet se dënimi I shqiptuar ka pasur efektin edukativ, ndërsa i dënuari ka mbajtur gjysmën e dënimit, mundë të parashtohet kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Kërkesa i parashtrohet Komisionit disiplinor të shkallës së parë, i cili krejt lëndën me propozimin të tij ja parashtron për të vendosur organit disiplinor të shkallës së dytë. Nëse organi disiplinor i shkallës së dytë konstaton se kërkesa është e bazuar mundë të nxjer vendim për zbutjen e dënimit apo lirimit nga mbajtja e mëtatjshme e dënimit. Kundër vendimit të kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nuk ka të drejt në ankes. Kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit mundë ta parashtroj I dënuari apo anëtari gjegjësisht udhëheqësia e të cilit ai është anëtar. Kërkesa për zbutje e jashtëzakonshme të dënimit mundë të parashtrohet vetëm njëher.



FEDERATA E MUNDJES E KOSOVËS KOSOVA WRESTLING FEDERATION

SHTËPIA E SPORTIT

ADRESA: RR. "AGIM RAMADANI" NR.43; 10000 PRISHTINË, KOSOVË
TEL/FAX: + 00381 221 811 *** www.kosova-wrestling.com

Neni 50

Kërkesa për zbutje e jashtëzakoshme të dënimit për përjashtim nga FMK mundë të parashtrohet kur së paku kalojn dy vite prej momentit të plotëfuqishmëris së vendimit për dënim.

Kërkesa mundë të përsëritet pas kalimit të dy viteve nga dita parashtrimit të kërkesë së parë.

VI- DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 51

Interpretimin obligativ të kësaj rregullore e bënë Bordi i FMK-se .

Neni 52

Kjo rregullore hyn në fuqi në seancën menjëher ne ditën e miratimit.

Prishtine
06.10.2022

